



KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

VENDIM

Nr. 48 datë 25.08.2011

Për dhënien e ndihmës familjes të dëmtuar nga zjarri.

Këshilli i Bashkisë Korçë në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Sek. i Shërbimeve Komunitare dhe Emergjencave Civile, Drejtoria e Financës dhe Drejtoria Juridike, " Për dhënien e ndihmës financiare për familjen e dëmtuar", bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.206 datë 26.03.1998, i ndryshuar, " Për kriteret për pjesëmarrjen e shtetit në përballimin e demeve në raste fatkeqësish" Ligjin nr.8652 datë 31.07.2000 " Për organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore" " neni 32, gërma dh. në ligjin nr.9936dt. 26.062008. " Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë " nr 10355 dt. 02.12.2010 " Për buxhetin e vitit 2011, Udhëzimin nr 4 MF dt. 02.12.2010 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2011" si dhe në VKB nr dt " Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë për vitin 2011"

VENDOSI

1. Të ndihmohen familjet të cilat u dëmtuan nga zjarri i rënë në pallatin nr 10 i ndodhur në lagjen nr 6. në Rrugën " M.Shkodrani" Përbërja e familjeve ditën e aksidentit është e vetëtuar nga Zyra e Gjëndjes Civile. Masa e ndihmës për dëmin në pajisje dhe orendi për secilen familje do të jetë si me poshtë:

Familja e qytetarit Nikolin Pano është e përbërë nga 3 persona	3x 20000= 60 000
Familja e qytetarit Mihal Parizi është e përbërë nga 3 persona	3x 20000= 60 000
Familja e qytetarit Bashkim Haxhi është e përbërë nga 5 persona	5x 20000= 100 000
Familja e qytetarit Barjan Zyberi është e përbërë nga 4 persona	4x 20000= 80 000
Shuma	300 000 lek

2. Dokumenti i plotë, për ndihmën e familjeve të katit të tretë për dëmtimet e shkaktuara në anën ndërtimore, me vlerë 2 233 602 lek dhe për familjet e katit të dytë për dëmet me vlerë 438 228 lek ti dërgohet Keshillit të Qarkut për t'ia përcjellë për shqyrtim Ministrisë së Brëndëshme. (Dep. të Planifikimin e Përballimit të Emergjencave Civile.

3.Ky fond do të përballohet nga fondi i emergjencave civile të miratuar në buxhetin e Bashkisë për vitin 2011 me strukturë buxhetore:

00 04980

05 Art. 6061041

Vlerë 300 000 lek

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës Sek. Shërbimeve Komunitare dhe Emergj.Civile dhe Drejtoria Juridike.

5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes.

KRYETARI

Ilir PENDAVINJI



Dixhitalizuar nga Qendra e PD
www.infocip.org